

REFERAT

për zgjedhjen e asistentit në lëminë e Inxhinierisë së tërmeteve (20703)
nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit
Ndërkombëtar të Fraskatit

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 82/2018) neni 158 të Statutit të Universitetit të Tetovës dhe në bazë të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, në lidhje me Konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe zgjedhje-rizgjedhje të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës të shpallur më datë 25.10.2023 në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat”, si dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit të Shkencave Aplikative në seancën e mbajtur më datë 09.11.2023, mori vendim (nr. 17-566/6 dt. 09.11.2023), për formimin e Komisionit recenzues në këtë përbërje:

1. Prof. inord. Dr. Koce Todorov, kryetar
2. Prof. Dr. Elena Dumova-Jovanoska, anëtare
3. Prof. Dr. Enis Jakupi, anëtar

Si anëtarë të Komisionit recenzues, pas shqyrtimit të dokumentacioneve të dorëzuar sipas konkursit, të shpallur, e paraqesim këtë:

RAPORT

Në konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të një asistenti në lëminë e Inxhinierisë së tërmeteve (20703), në afatin e paraparë është paraqitur një kandidat: Mr. Leart Taravari, ing. i dipl. i ndërtimarisë.

1. TË DHËNAT BIOGRAFIKE DHE ARSIMIMI

Kandidati Mr. Leart Taravari ka lindur më 12.04.1995 në Shkup, Republika e Maqedonisë. Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në Gostivar, me sukses të shkëlqyer. Si nxënës i shkollës fillore dhe të mesme ka marrë pjesë në më shumë gara në fusha të ndryshme, për të cilat ka marrë çmime dhe mirënjohje. Është fitues i tre medaljeve të argjendta nga Olimpiadat e matematikës në vend dhe një medalje bronzi nga Olimpiada Ballkanike e Matematikës për Junior, e mbajtur në Valçea të Rumanisë.

Ciklin e parë të studimeve universitare katërvjeçare me 240 kredite ECTS, në programin studimor të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv, e ka kryer në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në tetor të vitit 2016, me notë mesatare 9.90, me çka ka marrë titullin profesional inxhinier i diplomuar i ndërtimit.

Studimet akademike njëvjeçare master (cikli i dytë me 60 kredite ECTS) për inxhinieri konstruktive me projektim asezimik, si bursist në Institutin për Inxhinieri Tërmeti dhe Sizmologji Inxhinierike – Shkup pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, i ka përfunduar në vitin

2020, me notë mesatare 10.00. Me mbrojtjen e temës së magjistraturës me titull “Kërkime eksperimentale-analitike mbi sjelljen sizmike të konstruksioneve prej betoni të armuar me kat fleksibël”, merr titullin magjistër i shkencave në fushën e inxhinierisë së tërmeteve.

Në tetor 2020 regjistrohet në ciklin e tretë të studimeve akademike – studimet e doktoratës në ndërtimtari, nënprogrami: konstruksione, në Fakultetin e Ndërtimtarisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup. Në kuadër të studimeve të doktoraturës, në periudhën prej 23.01.2023 deri më 3.02.2023, kandidati ka bërë një qëndrim dhjetëditor studimor në Institutin IUSS në Universitetin e Pavia, Itali. Aktualisht, kandidati është duke punuar në hulumtime për përgatitjen e më pas aplikimin për disertacion doktorature.

Në fund të vitit 2020, në një konkurs publik me vendim të këshillit mësimor-shkencor (vendimi nr. 17-918/5 dt. 29.12.2020) u zgjodh në thirrjen e bashkëpunëtorit asistent në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara pranë Universitet të Tetovës, ku edhe punon aktualisht.

Si konfirmim i suksesit gjatë arsimimit akademik, kandidati është fitues i disa mirënjohjeve, ndër të cilat: Mirënjohja për studentin më të mirë të diplomuar në Fakultetin e Ndërtimtarisë në Shkup, të ndarë nga Universiteti “Shën Kiril dhe Metodi” në Shkup dhe Mirënjohja Unaza Inxhinierike nga Institucioni Inxhinierik i Maqedonisë dhe Oda e Arkitektëve të Autorizuar dhe Inxhinierëve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë.

Kandidati Mr. Leart Taravari, në mënyrë aktive shërbehet me gjuhën serbo-kroate, turke dhe angleze (posedon certifikata për njohjen e gjuhës angleze, të lëshuara nga Fakulteti Filologjik “Bllazhe Koneski” pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup në vitin 2020 dhe nga Qendra për Gjuhë të Huaja, kurse përgatitore dhe trajnime “Fluent” në vitin 2023.

Kandidati posedon me njohuri dhe shkathtësi të shkëlqyera në teknologjinë e informatikës: programe të përgjithshme nga paketa Microsoft Office, paketa softuerike profesionale: CS01 (SAP2000, ETABS), Radimpex Tower, AutoCAD, Autodesk Robot Structural Analysis, MATLAB etj.

2. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Kandidati Mr. Sc. Leart Taravari në vitin akademik 2017/2018 ka qenë i angazhuar si demonstrator në Katedrën për konstruksione të betonit dhe drurit në Fakultetin e Ndërtimtarisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, ku ka marrë pjesë në realizimin e ushtrimeve në lëndët: Beton i armuar, Beton i parandëruar dhe Ura të betonit të armuar. Që nga zgjedhja e tij si asistent bashkëpunëtor në Fakultetin e Shkencave Aplikative pranë Universitetit të Tetovës e deri më sot ka marrë pjesë në realizimin e ushtrimeve në lëndët: Materiale ndërtimore, Fundamentet, Konstruksionet e çelikut 1 dhe Konstruksionet e çelikut 2.

3. VEPRIMTARIA KËRKIMORE-SHKENCORE

Paralelisht me veprimtarinë mësimore-arsimore, kandidati Mr. Leart Taravari merr pjesë aktive në një sërë aktivitetesh që lidhen me veprimtarinë kërkimore-shkencore. Kërkimet e tij dhe punimet e botuara kryesisht i orienton në fushën e inxhinierisë së tërmeteve dhe të njëjtat janë të lidhura ngushtë me fushën shkencore që është objekt i përzgjedhjes për këtë konkurs. Punime

shkencore dhe profesionale të publikuara nga përzgjedhja e fundit:

1. Leart Taravari, Daniel Velinov, Koce Todorov, APLIKIMI I MODELËVE TË PROBABILITETIT PËR VLERËSIMIN E AKTIVITETIT SIZMIK TË GADISHULLIT BALLKANIK DHE MJEDISI I TIJ AFËRT, Simpoziumi i 19-të i DGKM-së, Ohër, 2022
2. Leart Taravari, Lisa Jusufi, Borjan Petreski, Koce Todorov, ANALIZA E BAZUAR NË PERFORMANCË TË KORNIZËS SHUMËKATËSHE DHE ME SHUMË SHTRIRJE TË BETONIT TË ARMUAR, Simpoziumi i 20-të i DGKM-së, Shkup, 2023
3. Leart Taravari, Koce Todorov, ANALIZA KRAHASUESE TË QASJEVE TË NDRYSHME PËR MODELIM JOLINEAR TË KORNIZAVE TË BETONIT TË ARMUAR, Simpoziumi i 20-të i DGKM-së, Shkup, 2023
4. Leart Taravari, Denis Popovski, Mile Partikov, ANALIZA KRAHASUESE E SJELLJES PROJEKTUESE SIZMIKE TË RAMAVE KARAKTERISTIKE TË ÇELIKUT, Simpoziumi i 20-të i DGKM-së, Shkup, 2023
5. Lisa Jusufi, Leart Taravari, Borjan Petreski, HULUMTIM I PARIMEVE TË VLERËSIMIT TË RREZIKUT SIZMIK PËRMES NJË RASTI STUDIMOR KARAKTERISTIK, Simpoziumi i 20-të i DGKM-së, Shkup, 2023

KONKLuzion DHE PROPOZIM

Në bazë të vlerësimit të dokumentacionit të përgjithshëm të dorëzuara, Komisioni recenzues konkludon se kandidati Mr. Leart Taravari posedon kualitete dhe i plotëson kushtet e përgjithshme për zgjedhje në thirrjen asistent, të përcaktuara në nenin 170 të Ligjit për arsim të lartë.

Kandidati mr. Leart Taravari me punën e deritanishme të suksesshme dhe të pëkushtuar në periudhën kohore 3 vjeçare si bashkëpunëtor asistent, me kualitetin e mbajtjes së ushtrimeve, të konsultimeve të rregullta dhe aktivitetëve tjera, e me theks të veçantë në veprimtarinë kërkimore-shkencore, tregon se ka ndërtuar një kapacitet kualitativ në përgjegjësitë si asistent. Duke i marrë në konsideratë të lartëpërmendurat, komisioni recenzues ka nderin dhe kënaqësinë që Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Shkencave Aplikative pranë Universitetit të Tetovës, ta zgjedhë Mr. Sc. Leart Taravarin në thirrjen asistent në lëminë e Inxhinierisë së tërmeteëve.

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN BASHKËPUNËTOR-ASISTENT

Kandidati: Leart Taravari

Nr. Rend.	KUSHTET E PËRGJITHSHME	Përmbushja e kushteve të përgjithshme po/jo
1	Ka kryer ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike me së paku 300 kredite ECTS	PO
2	Titulli i fituar - magjistër në fushën përkatëse Emërtesa e fushës shkencore: Inxhinieria e tërmeteve	PO
3	Suksesi mesatar i arritur të paktën 8.00 (tetë) në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve akademike veç e veç: Suksesi mesatar i ciklit të parë është: 9.90 Suksesi mesatar i ciklit të dytë është: 10.00	PO
4	Ka njohuri të paktën një gjuhë të huaj Gjuhë e huaj: Anglisht (C2) Emri i dokumentit: Certifikata nr. 03-1077/2 Lëshues i dokumentit: Fakulteti Filologjik, USHKM, Shkup Data e lëshimit të dokumentit: 11.09.2020	PO

Komisioni recenzues:

1. Prof. inord. Dr. Koce Todorov, kryetar
2. Prof. Dr. Elena Dumova-Jovanoska, anëtar
3. Prof. Dr. Enis Jakupi, anëtar